



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës ETIKA NË BIZNES

Të dhëna bazike të lëndës

Njësia akademike:	FAKULTETI I BIZNESIT
Titulli i lëndës:	Etika në Biznes
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II /semestri III
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vleran e kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	UHZ
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	

Përshkrimi i lëndës

Etika në Biznes është një fushë kyçe që shqyrton parimet dhe normat që udhëheqin veprimet dhe vendimet e individëve dhe organizatave brenda një konteksti ekonomik. Kjo disiplinë ndihmon në kuptimin e arsytimit moral dhe përgjegjësisë që kanë aktorët ekonomikë ndaj shoqërisë dhe ambientit.

Njohuritë bazike mbi etikën përfshijnë njohjen e parimeve thelbësore që formojnë praktikën e drejta dhe të ndershme në biznes. Diskutimet rreth tregut dhe etikës, si dhe implikimet e kapitalizmit, ndihmojnë në vlerësimin e ndikimit që kanë aktivitetet ekonomike në shoqëri. Një aspekt i rëndësishëm është mbrojtja e konsumatorëve, që kërkon që bizneset të veprojnë me përgjegjësi dhe të ofrojnë produkte dhe shërbime të sigurta dhe të drejta.

Kur flasim për diskriminimin në punë, etika bëhet jashtëzakonisht e rëndësishme, duke kërkuar nga organizatat krijimin e një ambienti pune të barabartë dhe të drejtë për të gjithë punonjësit. Etika e shoqërive tregtare gjithashtu luan një rol të rëndësishëm, duke përfshirë përgjegjësinë morale të korporatave për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë.

Programet e menaxhimit etik janë të domosdoshme për t'i ndihmuar organizatat të integrojnë praktikën etike në strategjitë e tyre. Këto programe ndihmojnë

	në identifikimin dhe zgjidhjen e dilemave etike që mund të lindin në përditshmërinë e biznesit. Duke u fokusuar në beneficencën dhe komunikimin etik në biznes, si dhe në procesin e auditimit dhe kuadrin ligjor për auditimin etik, ky studim do të ofrojë një kuptim të thellë të rëndësisë së etikës në biznes. Kjo është thelbësore për krijimin e një ambienti që promovon përgjegjshmërinë dhe respektin ndaj të gjithëve, duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është të ofrojë njohuri dhe aftësi mbi konceptet dhe praktikët etike në biznes, me theks të veçantë në rëndësinë e etikës në vendimmarrje dhe veprimet e organizatave. Ajo ka për qëllim të ndihmojë studentët të kuptojnë parimet etike, të analizojnë dilemat e ndryshme që ndodhin në mjedisin e biznesit, dhe të zhvillojnë strategji për të promovuar një kulturë etike brenda organizatave. Kështu, lënda kontribuon në formimin e profesionistëve të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për ndikimin e veprimeve të tyre në shoqëri dhe ambient.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë parimet etike për të identifikuar dhe adresuar dilemat komplekse që lindin në mjedisin e biznesit. *NJ2. Studentët do të vlerësojnë ndikimet e praktikave etike dhe përgjegjësisë sociale në performancën organizative dhe mirëqenien shoqërore. *NJ3. Studentët do të zotërojnë njohuri mbi teoritë kryesore etike dhe ndikimin e tyre në procesin e vendimmarrjes në kontekste të ndryshme të biznesit. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1. Studentët do të zhvillojnë aftësi kërkimore për të analizuar dhe interpretuar çështje etike duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore. **A-K2. Studentët do të aplikojnë parimet e ekonomiksit menaxherial për të adresuar dhe zgjidhur çështje etike komplekse.

	A-K3. Studentët do të krijojnë dhe zbatojnë strategji menaxhimi që promovojnë dhe inkurajojnë një kulturë etike brenda organizatave. **A-K4. Studentët do të udhëheqin projekte dhe iniciative që harmonizojnë etikën me objektivat strategjike të organizatës. **A-K5. Studentët do të përdorin analiza të të dhënave mbi çështje etike për të mbështetur vendimmarrjen efektive dhe të qëndrueshme. Aftësi (A): *A1. Studentët do të zhvillojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë bindëse dhe argumentuese mbi tematika komplekse etike në biznes. ***A2. Studentët do të tregojnë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekipe dhe për të udhëhequr nisma që integrojnë etikën në proceset organizative. ***A3. Studentët do të ndihmojnë në ndërtimin dhe përmirësimin e kulturës etike në organizata duke përdorur qasje inovative dhe strategjike. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	6	6
Ushtrime në teren	3	1	3
Kollokfiume,seminare	3	1	3
Detyra të shtëpisë	1	9	9
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	2	6	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1	3
Projektet, prezentimet,etj	4	1	4
Totali			125
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 125 orë ÷ 25 = 5 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda do të zhvillohet në tri orë ligjerata në javë dhe dy ushtrime. Gjatë ligjeratave do të shtjellohet materiali mësimor dhe do të kërkohet diskutim interaktiv. Gjatë ushtrimeve, materiali i shtjelluar në ligjerata do të dorishikohet nga pikëpamja praktike. Do të shyrtohen raste të ndryshme studimore, çështje aktuale nga fusha e Etikës në Biznes dhe do të organizohen biseda grupore Studentët do të përgatisin punime seminarike të cilat do të vlerësohen si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm.		
Metodat e vlerësimit:	Projekti hulumtues/ kërkimor 40% Vijueshmëria dhe ineteraktiviteti në klasë 10% Provimi final 50%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Hysen Çela – Etika e Biznesit, Tiranë, 2013 2. Ethics and Business An Introduction Second Edition KEVIN GIBSON Marquette University, WisconsinFirst published 2007 Second edition 2023		
Literatura shtesë:	1. O. C. Ferrel, John Fraedrich, Linda Ferrel – Business Ethics Ethical Decision Making and Cases, 2015, 11th edition. 2. William H. Shaw & Vicent Barry, Moral Issues in Business, 2014. 13th edition.		
Plani i dizejnuar i mësimi:			

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<i>Hyrje në etikën në biznes- njohuri bazike</i>
Java e dytë:	<i>Etika dhe arsyetimi mora;Përgjegjësia</i>
Java e tretë:	<i>Parimet kryesore etike në biznes</i>
Java e katërt:	<i>Tregu dhe etika ;Kapitalizmi dhe implikimet e tij etike</i>
Java e pestë:	<i>Tregjet dhe mbrojtja konsumatore</i>
Java e gjashtë:	<i>Diskriminimi i punës dhe aspektet etike të tij</i>
Java e shtatë:	<i>Prezantimi i detyrave të dhëna dhe diskutime</i>
Java e tetë:	<i>Etika e shoqërive tregtare</i>
Java e nëntë:	<i>Përgjegjësia morale e korporatave</i>
Java e dhjetë:	<i>Programet e menaxhimit etik</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Dilemat etike dhe zgjidhja e tyre</i>
Java e dymbëdhjetë:	<i>Beneficenca dhe Komunikimi Etik në Biznes</i>
Java e trembëdhjetë:	<i>Raportimi dhe auditimi etik dhe social</i>
Java e katërbëdhjetë:	<i>Procesi i auditimit dhe kuadri ligjor për një auditim etik</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Prezantimi i projekteve kërkimore/ shkencore</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Ata duhet të vijnë me kohë në mësim, të jenë të disiplinuar dhe të jenë aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Studentët duhet t'i përmbushin në tërësi detyrat të cilat iu parshtrihen në kuadër të lëndës.